



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Zl.Anr.68/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevcu anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçanë, për shkak të vendosjes së posterëve në shtyllat e ndriçimit publik për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, ndërkaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Deçanë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 500.00 (pesëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 26.09.2017, në rrugën “Enver Dobraj” në Deçanë, monitoruesit e tyre kanë hasur në poster të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të vendosur në hapësira publike përkatësisht në shtyllat e ndriçimit publik. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave zgjedhore në momentin që ka vendosur posterët e kandidatëve në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkëngjitur dy fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigjen në ankesë nga subjekti politik AAK, të datës 27.09.2017, ka deklaruar se vendosja e posterit në rrugën “Enver Dobraj” nuk është bërë nga ana e strukturave të AAK-së dhe se atë mund ta ketë vendosur ndonjë qytetar apo individ i pa identifikuar, mirëpo edhe përkundër kësaj pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së, subjekti në fjalë ka ndërmarrur masat përmirësuese, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkëngjitur një fotografi nga vendi ku është larguar posteri.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografit e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se poster të kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunalë nga radhët e subjektit politik AAK janë ngjitur në shtyllat e ndriçimit publik, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që poster të kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunalë të Këtij subjekti, janë vendosur në shtyllat e ndriçimit publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër të këtij fakti poster të kandidatit të këtij subjekti politik janë vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 68/2017 më datën 28.09.2017.



Kryesuesi i Panelit
Gyltene Sylejmani

Gyltene Sylejmani

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par.4të LZP-së.